

## **LUTJE E NXEHTË PËR NDALIMIN E LUFTËS VËLLAVRASËSE DHE PAQTIMIN NË UKRAINË**



Duke marrë shkas nga ngjarjet dramatike në Ukrainë, Fortlumtura e Tij, Kryepiskopi i Tiranës dhe i Gjithë Shqipërisë, Anastasi, i fton besimtarët dhe çdo njeri vullnetmirë të intensifikojnë lutjen e tyre për paqe dhe thekson se:

“Dhimbja dhe hidhërimi i thellë mbushin shpirtrat e njerëzve kur ndërpritet dialogu për paqen dhe nis lufta vëllavrasëse me monologun e dhunës së të fortit dhe me viktima, zakonisht njerëz të pafajshëm, të pambrojtur dhe valët e refugjatëve.

Ndërgjegjja e krishterë dënon çdo formë akti dhune, duke nxitur fort secilin të kontribuojë sipas mundësisë në arritjen e paqes dhe pajtimit në Ukrainën e shumëvuajtur dhe kudo në botë.

Parimi ynë i përhershëm mbetet fjala e Krishtit: “Lum ata që bëjnë paqe, sepse këta do të quhen bij Perëndie”.